

## Vendim nr. 183 datën 11.09.2023

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Holta Zaçaj,	Kryetare
Fiona Papajorgji,	Anëtare
Sonila Bejtja,	Anëtare

në datën 11.09.2023 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 14 (Sh) 2023 të Regjistrimit Themeltar, që i përket:

**KËRKUESE:**                   **SHOQËRIA “SIG SHIP” SH.P.K.**

**OBJEKTI:**                   **Shfuqizimi i vendimit nr. 00-2021-1432, datë 23.09.2021 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.**

**BAZA LIGJORE:**           Nenet 42, pika 1, 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; neni 6 i Protokollit nr. 7 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; nenet 27 dhe 28 të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoi relatorin e çështjes Sonila Bejtja, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese dhe diskutoi çështjen në tërësi,

### V Ë R E N:

#### I

#### Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesja ushtron veprimtari tregtare në fushën e mbrojtjes të së drejtës së autorit, lidhur me sigurimin e punëve private të kompozitorëve, këngëtarëve dhe muzikantëve në ambientet tregtare. Në funksion të veprimtarisë së saj kërkuesja ka lidhur kontrata të

ndryshme porosie me disa subjekte. Këto të fundit kanë shpërblyer kërkuesen për përdorimin e veprave muzikore audiovizive në ambientet ku ushtronin aktivitet tregtar bazuar në kontratat e lidhura.

2. Mbi bazën e informacionit të referuar nga subjektet e mësipërme, Zyra Shqiptare për të Drejtat e Autorit (ZSHDA) ka nxjerrë gjobën me nr. serie 000451, datë 03.12.2010, me vlerë 850.000 lekë. Sipas ZSHDA-së, kërkuesja ka konsumuar shkeljen administrative të parashikuar nga neni 130, shkronja “h”, i ligjit nr. 9380, datë 28.04.2005 “Për të drejtën e autorit dhe të drejta të lidhura me të” (*ligji nr. 9380/2005*), konkretisht: kryen veprime si ndërmjetës ose si agjenci për administrimin kolektiv të së drejtës së autorit ose të artistëve të tjerë kur nuk është pajisur me licencë për ushtrimin e kësaj veprimtarie.

3. Ndaj vendimit të mësipërm të ZSHDA-së, kërkuesja në datën 13.12.2010 ka ushtruar ankim administrativ, për të cilin nuk ka marrë përgjigje. Kështu, bazuar në nenin 32 të ligjit nr. 9380/2005, ankimi është vlerësuar se nuk është pranuar. Në këto kushte, ZSHDA-ja i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, e cila, me vendimin e datës 21.03.2011, ka vendosur lëshimin e urdhrin të ekzekutimit për gjobën nr. 000451, datë 03.12.2010. Kërkuesja, duke pretenduar se titulli ekzekutiv është i pavlefshëm, pasi është një akt administrativ i nxjerrë në kapërcim të kompetencave ligjore, i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë për shfuqizimin e tij.

4. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 4222, datë 19.04.2013, ka vendosur rrëzimin e kërkesëpadisë. Ky vendim është lënë në fuqi nga Gjykata Administrative e Apelit me vendimin nr. 2231, datë 13.07.2016. Kundër këtij vendimi ka bërë rekurs kërkuesja.

5. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, në dhomë këshillimi, me vendimin nr. 00-2021-1432, datë 23.09.2021, ka vendosur mospranimin e rekursit, me arsyetimin se bazuar në nenin 56 të ligjit nr. 49.2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, të ndryshuar, ndaj vendimit të kundërshtuar nga kërkuesi nuk mund të bëhet rekurs, për shkak se titulli ekzekutiv objekt padie përmban një vlerë më të vogël se dyzetfishi i pagës minimale.

6. Në datën 05.06.2023 (sipas shënimit të shërbimit postar) kërkuesja ka paraqitur ankim kushtetues individual në Gjykatën Kushtetuese (*Gjykata*) për shfuqizimin e vendimit nr. 00-2021-1432, datë 23.09.2021 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë. Ky ankim është plotësuar në datën 29.06.2023, sipas parashikimeve të nenit 27, pika 5, të ligjit nr. 8577/2000.

7. Bazuar në nenet 15, pika 2 dhe 21, pika 1, të Rregullores për Procedurat Gjyqësore të Gjykatës Kushtetuese, në afatin 3-mujor për shqyrtimin paraprak të çështjes, të përcaktuar në nenin 47, pika 1, të ligjit 8577/2000, nuk llogaritet periodha e lejes vjetore të anëtarëve të Gjykatës Kushtetuese, sipas nenit 18, pika 1, shkronja “b”, të po këtij ligji.

## II

### Pretendimet e kërkuases

8. **Kërkuësja** ka pretenduar se i është cenuar procesi i rregullt ligjor, pasi ajo ka kërkuar pavlefshmërinë e aktit administrativ dhe gjykatat kishin detyrimin të vlerësonin vlefshmërinë e këtij akti. Ajo ka pretenduar se në asnjë rast nuk ka kundërshtuar masën e gjobës së vendosur me anë të aktit administrativ.

## III

### Vlerësimi i Kolegjit

#### A. Për legjitimitimin e kërkuases

9. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është vlerësuar nga Gjykata si një ndër aspektet kryesore që lidhet me inicimin e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i” dhe pika 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret kumulative të nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuara në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës.

10. Në rastin konkret kërkuësja legjitimohet *ratione personae*, pasi ka qenë palë në procesin gjyqësor ku është dhënë vendimi i kundërshtuar, për rrjedhojë ka interes të drejtpërdrejtë për çështjen e parashtruar.

11. Në lidhje me kriterin e *shterimit të mjeteve juridike efektive*, kërkuësja i është drejtuar Gjykatës me ankim kushtetues individual pas përfundimit të procesit gjyqësor në të tria shkallët e gjyqësorit të zakonshëm dhe nuk ka më mjete për të shteruar përveç ankimit në këtë Gjykatë, për rrjedhojë e plotëson edhe këtë kriter.

12. Në lidhje me legjitimimin *ratione temporis*, bazuar në nenin 71/a, pika 1, shkronja “b”, të ligjit nr.8577/2000, afati për paraqitjen e ankimit kushtetues individual është 4 muaj nga konstatimi i cenimit të së drejtës.

13. Nga aktet bashkëlidhur kërkesës, Kolegji vëren se procesi gjyqësor i kundërshtuar nga kërkuesja ka përfunduar me vendimin nr. 00-2021-1432, datë 23.09.2021 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, kurse ankimi kushtetues individual është paraqitur në këtë Gjykatë në datën 05.06.2023, pra pas 21 muajsh. Referuar faqes zyrtare të Gjykatës së Lartë rezulton se në datën 03.09.2021 është publikuar data e zhvillimit të gjykimit të çështjes së kërkueses, e parashikuar për t’u zhvilluar në datën 23.09.2021. Po në datën 23.09.2021, në faqen zyrtare të internetit të Gjykatës së Lartë, është shpallur edhe dispozitivi i vendimit për çështjen e saj. Ndërkohë, në kërkesën drejtuar Gjykatës, kërkuesja nuk ka parashtruar asnjë argument në lidhje me momentin e marrjes dijeni të vendimit që kundërshton, por bashkëlidhur ka paraqitur shkresën nr. 2866/1 prot., datë 01.06.2023 të kancelarit të Gjykatës së Lartë, nëpërmjet së cilës evidentohet se vendimi i kundërshtuar është bërë i disponueshëm për palët në datën 21.10.2021 dhe është publikuar në faqen zyrtare të internetit të Gjykatës së Lartë në datën 28.10.2021.

14. Në këtë kuptim, nisur edhe nga fakti se kërkuesja ka qenë në dijeni për zhvillimin e gjykimit në Gjykatën e Lartë dhe ka pasur detyrimin të ndjekë fatin e çështjes së saj, Kolegji evidenton se vendimi është bërë i disponueshëm për kërkuesen në datën 28.10.2021, vërtetuar kjo nga shkresa e kancelarit të Gjykatës së Lartë, e paraqitur nga vetë ajo. Duke iu referuar kësaj date, ankimi kushtetues individual i paraqitur nga kërkuesja nuk plotëson kriterin *ratione temporis*, pasi është paraqitur jashtë afatit ligjor 4-mujor të përcaktuar në nenin 71/a, pika 1, shkronja “b”, të ligjit nr. 8577/2000.

15. Për sa më sipër, për sa kohë kërkesa është paraqitur jashtë afatit ligjor dhe kërkuesja nuk legjitimohet *ratione temporis* për vënien në lëvizje të gjykimit kushtetues, Kolegji çmon se nuk është e nevojshme të vijohet më tej me verifikimin e plotësimit të kritereve të tjera kumulative të pranueshmërisë së kërkesës.

16. Në përfundim, Kolegji vlerëson se ankimi kushtetues individual i paraqitur nga kërkuesi nuk plotëson kriteret ligjore për kalimin për shqyrtim në seancë plenare.

## **PËR KËTO ARSYE,**

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pika 2, shkronja “ç”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

**V E N D O S I:**

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.